



VENDIM

Nr. 36, Datë 06.03.2017

**PËR
LICENSIMINE SHOQËRISË “ENPI” SH.P.K., NË AKTIVITETIN E
TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, gërma ”d” të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, neneve 5, gërma “e”; 13 dhe 21 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, Nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 15 të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin Nr.96, datë 17.06.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 06.03.2017, mbasi shqyrtoi relacionin për licensimin e shoqërisë “ENPI” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike, përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut,

Konstatohet se:

Bordi i ERE-s, me Vendimin Nr.21, datë 31.1.2017, ka vendosur “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për licensim të shoqërisë “ENPI” sh.p.k., në aktivitetin e Tregtimit të Energjisë Elektrike”.

Aplikimi i shoqërisë “ENPI” sh.p.k. , plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregullore për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike”, si më poshtë:

- Formati I aplikimit (neni 9, pika 1) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrative dhe pronësor (neni 9, pika 2) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9 pika 3) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

- Dokumentacioni teknik për aktivitetin e tregimit të energjisë elektrike (neni 9, pika 4/8 gërmat “a”, “b”, “c” dhe “d”) është paraqitur dhe plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa mësipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë Shoqërinë “ENPI” sh.p.k, në aktivitetin e Tregimit të Energjisë Elektrike, për një afat 5vjeçar.
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim mund të ankimohet në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI i ERE_s

Petrit AHMETI